



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE  
AMA**

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
AKEP**

Nr. 3520 Prot.

Nr. 481/9 Prot.

Tiranë, më 3. 11. 2021

Tiranë, më 3. 11. 2021

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

**Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**, organi rregullator në fushën e shërbimeve audio/audiovizive sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfaqësuar nga Kryetari Znj. Armela Krasniqi,

si dhe

**Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)**, organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, sipas ligjit nr. 9918 datë. 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i përfaqësuar nga Kryetari Z. Tomi Frashëri,

*Me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin në drejtime konkrete.*

*Duke synuar rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet AMA dhe AKEP me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të ofrimit të ndërsjellë të ekspertizës, garantimin dhe mbështetjen operacionale teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.*

Bazuar në:

- Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

si dhe në aktet nënligjore e rregullatore të dala në dhe për zbatim të tyre,

Palët bien dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi.

## **Neni 1** **Qëllimi**

Qëllimi i këtij memorandumi është:

1. Realizimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit me qëllim intensifikimin e marrëdhënieve të dy institucioneve dhe rritjen e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.
2. Bashkëpunimi dhe krijimi i grupeve të përbashkëta për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave në rastet kur ndërthuren fushat e kompetencës.
3. Zhvillimi i takimeve të rregullta midis përfaqësuesve të palëve si dhe hartimi i planeve të punës dhe kalendarëve të përbashkëta, në përputhje me parashikimet ligjore dhe ato nënligjore, që rregullojnë fushën e veprimtarive dhe funksioneve të të dy palëve.

## **Neni 2** **Angazhimi**

1. Palët angazhohen që të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij memorandumi në një mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase si dhe për realizimin sa më cilësor të qëllimit të tij.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për:
  - a. Lirimin e brezit 700 MHz nga AMA dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP, duke shkuar drejt respektimit të afateve të vendosura nga BE dhe ITU.
  - b. Ngritjen e një TASK-FORCE me përfaqësues të përbashkët nga të dy institucionet me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në rrjetet e komunikimeve elektronike dhe zhvillimin e veprimtarisë vetëm nga subjekte të licencuara/autorizuara nga autoritetet rregullatore.
  - c. Koordinimin në marrjen e masave në zbatim të legjislacionit organik të palëve me qëllim luftën kundër paligjshmërisë të kryer nga subjekte që ofrojnë përmbajtje audiovizive në internet në shkelje të të drejtave të transmetimit, pas konstatimit si të tillë nga AMA.
  - d. Ngritjen e një grupi të përbashkët, i cili do të ndjekë në vijueshmëri problemet e interferencave të shkaktuara nga subjekte, veprimtaria e të cilëve përfshihet në fushën e veprimit të këtyre institucioneve si dhe interferencave që raportohen nga autoritetet rregullatore të vendeve fqinje.
  - e. Krijimin e një inventari të unifikuar të frekuencave bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara për të dy institucionet nga VKM nr. 636 date 29.07.2020 "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit" si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

## **Neni 3** **Komunikimi**

1. Për efekt të zbatimit të këtij memorandumi, secila palë brenda afatit një mujor nga nënshkrimi i tij, të caktojë personat, të cilët do të jenë përgjegjës në mënyrë që shkëmbimi i të dhënave dhe/ose informacioneve të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm dhe masat e nevojshme të merren në kohë.
2. Palët marrin përsipër që, për efekt të zbatimit të këtij memorandumi të marrin të gjitha masat e nevojshme ligjore për të pajisur personat e përmendur në këtë nen me të gjitha lejet, urdhrat dhe/ose autorizimet e nevojshme (nga titullari, këshilli drejtues etj.) për të proceduar dhe/ose ndjekur apo për të kryer komunikime ose njoftime, sipas përcaktimeve ligjore dhe atyre nënligjore specifike që rregullojnë veprimtarinë institucionale të secilës palë, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me komunikimet ose njoftimet jashtë institucioneve përkatëse.

#### **Neni 4 Ndryshimet**

1. Palët, kurdoherë, mund të bëjnë përmirësime, ndryshime ose shtesa në këtë memorandum.
2. Në çdo rast, çdo shtesë ose ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e institucioneve përkatës dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

#### **Neni 5 Përdorimi i informacionit dhe konfidencialitetit**

1. Të gjitha informacionet ose të dhënat që do të merren në dhe për zbatim të këtij memorandumi, do të përdoren sipas kompetencave ligjore përkatëse të secilës palë dhe vetëm për qëllimin e përcaktuar në këtë memorandum.
2. Çdo informacion dhe/ose e dhënë që do të shkëmbehet në dhe për zbatim të këtij memorandumi do t'i nënshtrohet parimeve të mirëbesimit (konfidencialitetit), me përjashtim të atyre me karakter publik, të përcaktuara sipas akteve normative në fuqi.
3. Asnjëra prej palëve nuk ka të drejtë që të bëjë publike apo t'i kalojë, në çfarëdo lloj forme, të tretëve, informacionin ose të dhënat që do të marrë nga pala tjetër, pa autorizimin eksplicit të saj.
4. Secila palë ka detyrimin që të trajtojë punonjësit përkatës që do të caktohen për ndjekjen dhe zbatimin e përcaktimeve të këtij memorandumi, në lidhje me kufizimet e këtij neni.

#### **Neni 6 Afati i Memorandumit**

1. Ky memorandum lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Memorandumi mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga ky memorandum, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 7**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga ky memorandum.
2. Memorandumi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.
3. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një prej të cilave depozitohen në AMA dhe një në AKEP.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 03.11.2021.

**AUTORITETI I MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE  
AMA**

**KRYETARI**

*Armela Krasniqi*  
Znj. Armela Krasniqi



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
AKEP**

**KRYETARI**



*Tomir Erashëri*  
Z. Tomir Erashëri